



| | | | |
|--|-------------------------------|------------------------------|-------------------------------|
| Pranimi / Dorezuar Punëpunë/Prilato Recieved/Delivered | 05-01-2024 | 4 | Viti год Year |
| Organ /Ishesia Org /Jednica Org /Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtesa Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKIMSHOR | 96/2024 | | 115 |



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.641/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.2130/2021, të datës 19.09.2023, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.641/2021, të datës 15.07.2021, të ankuesit kundër organit të punësimit Këshilli i Sigurisë së Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafit 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 04.01.2024, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.641/2021, e datës 15.07.2021, e parashtruar nga ankuesi
- II. **Anulohet** Vendimi Nr.120/2021, i datës 05.07.2021, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit të Sigurisë së Kosovës.
- II. **Obligohet** Sekretari i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ankuesit ti bëjë kompensimin e mëditjeve të pa ekzekutuara, lidhur me ditët e udhëtimit zyrtar për pjesëmarrje dhe ndjekje të trajnimit me temën "Menaxhimi i mbrojtjes në kontekstin e gjerë të sigurisë", i mbajtur në Shrivenham-Britani e Madhe, nga data 28.05.2017 deri më 15.07.2017.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi *(tutje referuar ankuesi)*, me datë 15.07.2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.120/2021, të datës 05.07.2021, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit të Sigurisë së Kosovës, me pretendimet ankimore se vendimi i kundërshtuar me ankesë është i kundërligjshëm pasi që Komisioni, nuk ka shqyrtuar ankesën e datës 04.10.2017 lidhur me ekzekutimin e parave të xhepit, të përcaktuar në shumën prej 20% të mëditjeve, sipas nenit 2 dhe 13 të Udhëzimit Nr.2004/07, nenit 35 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil si dhe nenit 15 të Rregullores nr.33/2012.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*), bazuar në dispozitat e ligjore në fuqi me datën 16.11.2017 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Këshilli i Sigurisë së Kosovës, ndërsa, kjo e fundit më datë 24.11.2017, ka përcjell përgjigjen në ankesë si dhe shkresat ndërlidhur më çështjen.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Aktgjykimin me numër A.nr.2130/21 të datës 19.09.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Përgjigjen në padi të datës 24.01.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktvendimin me numër A.nr.2130/21 të datës 21.11.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Padinë e ankuesit-paditësit të datës 17.09.2021; Ankesën e ankuesit të datës 15.07.2021 me numër të protokollit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.120/2021 të datës 05.07.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin me numër A.nr.364/2021 të datës 04.06.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin me numër A.nr.102/2018 të datës 25.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje Administrative; Urdhër obligimin për pagesë me numër 31117086; Komunikimet elektronike të datës 10.10.2017, 04.10.2017, 02.10.2017, 28.09.2017, 07.03.2017, 03.03.2017; Dëshminë e marrjes së vizës së ankuesit; Kërkesën për udhëtim zyrtar me Nr.121/17 të datës 25.05.2017; Shkresën zyrtare të datës 05.07.2021 nga Këshilli i Sigurisë së Kosovës lidhur me zbatimin e vendimit të Këshillit; Vendimin me numër A/02/703/2017 të datës 21.12.2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin me numër A.nr.102/2018 të datës 06.05.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Përgjigjen në padi të datës 16.04.2019 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktvendimin me numër A.nr.102/18 të datës 05.04.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Padinë e ankuesit-paditësit të datës 22.01.2018; Ankesën e ankuesit të datës 06.11.2017 me numër të protokollit 5654/2017 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Komunikimet elektronike të datës 09.10.2017, 04.10.2017; 02.10.2017; Shkresën zyrtare të datës 18.04.2017 lidhur me trajnimin e ankuesit së bashku me shkresat e bashkangjitura për çështjen në fjalë;

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të Aktgjykimit me numër A.nr.2130/2021, të datës 19.09.2023, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe pas vlerësimit të hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se ankuesi ka qenë i punësuar në Këshillin e Sigurisë së Kosovës sipas Akt emërimit me Nr.prot.208/2013 të datës 31.07.2013 dhe ka ushtruar pozitën e punës Analist, në kuadër të Departamentit të Analizave dhe Politikave të Sigurisë.

Me tej nga shkresat e lëndës rrjedhë së ankuesi me datë 28.09.2017, i është drejtuar me kërkesë Drejtorit të Administratës në Sekretariatit e Këshillit të Sigurisë së Kosovës lidhur me kompensimin e mëditjeve për udhëtimin zyrtar në Britani të Bashkuar nga data 28.05.2018 deri më 15.07.2017, gjegjësisht për ndjekje të trajnimit me temën “ Menaxhimi i mbrojtjes në kontestin e sigurisë” të organizuar nga Akademia e Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar, bazuar në kërkesën e aprovuar me datë 25.05.2017 dhe me sqarimin se të gjitha shpenzimet e pjesëmarrjes së ankuesit në këtë trajnim janë mbuluar nga Ambasada Britanike në Prishtinë.

Tutje, Drejtori i Administratës në Sekretariatit e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, me datë 02.10.2017, në përgjigje të kërkesës së ankuesit ka njoftuar të njëjtin se ekzekutimi i mëditjeve nuk mund të bëhet, ngase udhëtimi zyrtar i realizuar është bërë në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ Nr.MSHP 2004/07 për Udhëtime Zyrtare, duke mos dhënë asnjë sqarim lidhur me shkeljet e pretenduara.

Ankuesi me datë 04.10.2017, ka parashtruar ankesë te Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave brenda institucionit, për shkak të mos ekzekutimit të mëditjeve, ndërsa, kryetari i këtij komisioni përmes e-mailit zyrtar të datës 10.10.2017, ka informuar ankuesin se Komisioni nuk mund të vendos për ankesën e datës 04.10.2017, në mungesë të njërës nga anëtarët, i cili ka ndërruar vendin e punës dhe se mbi këtë fakt komisioni nuk mund të nxjerr vendim lidhur me ankesën e ankuesit.

Më tej nga shkresat e lëndës rezultojnë se ankuesi me datë 06.11.2017, kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, lidhur me mos shqyrtimin e ankesës së datës 04.10.2017, ndërsa, Këshilli me vendimin me numër A/02/703/2017, të datës 21.12.2017, ka hedhur poshtë si të palejuar ankesën e ankuesit me arsyetimin se është paraqitur pas afatit të paraparë ligjor.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e Këshillit, ka hapur konfliktin administrativ në gjykatën kompetente, me ç' rast Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktgjykimit me numër A.nr.102/2018 të datës 25.03.2021, ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit-ankuesit, ka anuluar Vendimin me numër A/02/703/2017, të datës 21.12.2017, të Këshillit duke e kthyer çështjen në rishqyrtim tek e paditura-Këshilli.

Në zbatim të aktgjykimit A.nr.102/2018 të datës 25.03.2021, Këshilli me Vendimin A.nr.364/2021, të datës 04.06.2021, ka detyruar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit të Sigurisë së Kosovës që ta shqyrtoj ankesën e ankuesit të datës 04.10.2017, ndërsa, ky i fundit me datën 05.07.2021 ka nxjerrë Vendimin me Nr.12/202, sipas të cilit e ka hedhur poshtë ankesën e ankuesit të datës 04.10.2017, me arsyetimin se është paraqitur jashtë afatit ligjor.

I pakënaqur me Vendimin Nr.120/2021 të datës 14.10.2017 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit të Sigurisë së Kosovës, ankuesi sërish me datën 15.07.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, ndërsa, ky i fundit përmes njoftimit të datës 01.09.2021, ka njoftuar ankuesin lidhur me arsyetimin e mos shqyrtimit të ankesës, si rezultat se Këshilli nuk ka qenë funksional, duke udhëzuar të njëjtin për të drejtën e inicimit të konflikti administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, si gjykatë kompetente.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me Aktgjykimin me numër A.nr.2130/2021, të datës 19.09.2023, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 01.09.2021, duke e detyruar Këshillin që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankuesit të parashtruar në Këshill me datë 15.07.2021.

Në funksion të shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe në kuptim të vendosjes së drejtë dhe meritore, Kolegji i 'u referua dispozitave ligjore të aplikueshme në atë periudhë, gjegjësisht nenit 20 paragrafit 2 nën paragrafit 2.1, të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, me të cilin është përcaktuar se: *"Nëpunësit civilë kanë të drejtë në kompensimin e shpenzimeve të kryera gjatë ushtrimit të detyrës, si vijon: 2.1. shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit gjatë një udhëtimi apo vizite zyrtare brenda ose jashtë Kosovës"* si dhe dispozitave të nenit 15 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë sipas së cilës është përcaktuar se: *"Kompensimi i shpenzimeve gjatë vizitës zyrtare jashtë Kosovës 1. Sipas Nenit 20 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, kur një institucion i administratës publike cakton që një nëpunës civil të qëndrojë në një vend tjetër jashtë Kosovës, si pjesë e punës së tij/saj/, shpenzimet e udhëtimit dhe të gjitha shpenzimet e tjera të përcaktuara në këtë nen do të mbulohen nga institucioni. 2. Procedurat e kërkesës nga nëpunësit civilë, të përcaktuara në paragrafët nga 1 deri 4 të Nenit 15 të kësaj Rregulloreje, zbatohen edhe për vizita zyrtare jashtë vendit, me përjashtim të paragrafit 3, nën paragrafit 3.3 të Nenit 15 . 3. Kërkesa për aprovim për vizitë zyrtare jashtë vendit duhet të parashtrohet të paktën pesë (5) ditë pune para ditës së udhëtimit. 4. Aprovimi ose refuzimi i kërkesës nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit, në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni, duhet të bëhet*



më së largu tri (3) ditë para ditës së udhëtimit. 5. Përjashtimisht nga afati i përcaktuar në paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni, kërkesa për vizitë zyrtare mund të paraqitet, nëse përfaqësuesit e institucionit nuk janë njoftuar me kohë. 6. Pasi që udhëtimi zyrtar të jetë autorizuar, institucioni organizon udhëtimin me mënyrën më të përshtatshme për nëpunësin civil, duke marrë parasysh koston financiare të institucionit përkatës. 7. Për të mbuluar shpenzimet e vizitës jashtë vendit, nëpunësi civil ka të drejtë në mëditje për çdo ditë të vizitës zyrtare në pajtim me rregullat tvën ligjore ne fuqi për udhëtime Zyrtare. 8. Në rastin kur shpenzimet për vizitë zyrtare nuk janë mbuluar nga organizatori, te gjitha shpenzimet mbuloohen nga institucioni përkatës i nëpunësit civil. 9. Nëpunësi civil për shpenzimet gjatë vizitës zyrtare jashtë vendit, mund të marrë paradhënie nga institucioni i tij” .

Po ashtu, Kolegji morri parasysh edhe Udhëzimin Administrativ Nr. MSHP 2004/07 për Udhëtime Zyrtare, konkretisht nenin 11 dhe 12, sipas të cilëve është përcaktuar se: “1. *Pagesa për ditët e udhëtimit zyrtar fillon në ditën e nisjes dhe përfundon në ditën e kthimit. Dita e nisjes dhe dita e kthimit llogariten si ditë e udhëtimit zyrtar pa marrë parasysh kohën e nisjes apo të arritjes, 2.Shuma e mëditjeve paguhet sipas tarifave të përcaktuara nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave*”.

Andaj, nisur nga përcaktimi ligjor si më lartë, si dhe në mbështetje të provave materiale të çështjes, Kolegji ka konstatuar se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me të drejtën e realizimit të mëditjeve për ndjekje të trajnimit “Menaxhimi i mbrojtjes në kontekstin e gjerë të sigurisë”, i mbajtur në Shrivenham-Britani, nga data 28.05.2017 deri më 15.07.2017, sepse, nga provat e kësaj çështje rezulton se paraprakisht pjesëmarrja e ankuesit në këtë trajnim ishte miratuar nga Drejtori i DAPS me datë 07.03.2017, ndërsa, ankuesi para datës së udhëtimit zyrtar, kishte parashtruar kërkesë për aprovim të udhëtimit zyrtar për pjesëmarrje në këtë trajnim dhe se e njëjta kërkesë ishte miratuar nga Drejtori i DAPS si dhe Sekretari i Këshillit të Sigurisë së Kosovës si Udhëheqësi me i Lartë Administrativ i institucionit, kështu që, mbi bazën e këtyre fakteve, ankuesi kishte respektuar procedurat e udhëtimeve zyrtare, dhe si rrjedhojë deri sa me asnjë shkresë tjetër të organit të punësimit nuk dëshmohet se ankuesit i ishte refuzuar e drejta në mëditje me rastin e aprovimit të kërkesës së tij për udhëtim zyrtar, ankuesi ka gëzuar të drejtën e realizimit të kompensimit të mëditjeve për ditët e pjesëmarrjes në trajnim, në pajtim me dispozitat ligjore të zbatueshme në kohën e ndodhjes së udhëtimit zyrtar.

Lidhur me ligjshmërinë e vendimit të kontestuar me ankesë, Kolegji ka analizuar Vendimin Nr.120/2021 e datës 05.07.2021, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit të Sigurisë, dhe si rrjedhojë ka konstatuar së i njëjti bazohet në vërtetim jo të drejtë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për faktin se ankesa e ankuesit e parashtruar me datë 04.10.2017, nuk është ushtruar jashtë afatit ligjor, ngase kërkesat në të holla në kuptim të dispozitave të nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës, rrejdhimisht, ankuesi me datë 28.09.2017, ka parashtruar kërkesë për kompensim të mëditjeve brenda afatit, ndërsa, ankesa e datës 04.10.2017 kudër përgjigjes së datës 02.10.2017 të organit të punësimit, është parashtruar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku thuhet se: *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ..*”

Bazuar në konstatimet e mësipërme, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrejdhimisht aprovoj si të bazuar ankesën e ankuesit, anuloi vendimin Nr.120/2021 të datës 05.07.2021, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit të Sigurisë së Kosovës dhe obligoj Sekretarin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës që ankuesit në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr. MSHP 2004/07 për Udhëtime Zyrtare dhe Tarifat e përcaktuara nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave (si akte ligjore në fuqi në këtë periudhë), ti bëjë kompensimin e mëditjeve të pa ekzekutuara lidhur me ndjekjen e trajnimit “Menaxhimi i mbrojtjes në kontekstin e gjerë të sigurisë”, i mbajtur nga data 28.05.2017 deri më 15.07.2017, në Britaninë e Bashkuar.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.641/2021

Ardita Përçuku-Shyti

Ardita Përçuku
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Gjyqtarës Lirije Maksutaj- Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative
- Sekretarit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

